



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA SHKODËR

KRYETAR

Nr. 8531 Prot

Shkodër, më 23.06.2024

**Lënda: Dërgohet për shqyrtim relacioni dhe projekt-vendim “Për një shtesë plani dhe ndryshim në buxhetin e bashkisë Shkodër për projektin “Fuqizimi i komunitetit përmes ofrimit të shërbimeve ditore të alternuara për fëmijët dhe familjen”.**

### KËSHILLIT BASHKIAK SHKODËR

**Të nderuar këshilltarë,**

Bashkëngjitur ju dërgojmë për shqyrtim projekt-vendimin dhe relacionin: “Për një shtesë plani dhe ndryshim në buxhetin e bashkisë Shkodër për projektin “Fuqizimi i komunitetit përmes ofrimit të shërbimeve ditore të alternuara për fëmijët dhe familjen”.

*Duke ju uruar punë të mbarë.*

Me respekt,

**KRYETAR**

**Benet Beci**

Me Vendim Delegimi

Zv/Kryetar

Onid Bejleri





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA SHKODËR

KRYETAR

Nr. \_\_\_\_ Prot

Shkodër, më \_\_\_\_ . \_\_\_\_ .2024

### PROJEKT-VENDIM

Nr. \_\_\_\_\_, datë \_\_\_\_ . \_\_\_\_ .2024

**“Për një shtesë plani dhe ndryshim në buxhetin e bashkisë Shkodër për projektin “Fuqizimi i komunitetit përmes ofrimit të shërbimeve ditore të alternuara për fëmijët dhe familjen”.**

Këshilli Bashkiak Shkodër në mbledhjen e tij të datës \_\_\_\_ . \_\_\_\_ .2024, me propozim të Kryetarit të Bashkisë, në mbështetje të nenit 35 pika 1 shkronja “d”, nenit 54 shkronja “dh”, të ligjit nr.139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”, i ndryshuar ; nenit 20 pika 1 dhe 5, të ligjit nr. 68/2017 “Për financat e veteqerisjes vendore”, i ndryshuar; Ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar; pika 190 e udhëzimit nr. 9, datë 20.3.2018 të Ministrit të Financave dhe Ekonomisë “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit”, të ndryshuar, udhëzimit nr. 35, datë 21.09.2020 “Për kontrollin, regjistrimin, përdorimin, rakordimin, raportimin dhe publikimin e fondeve të financimeve të huaja në kuadrin e marrëveshjeve ndërkombëtare”, të ndryshuar; Udhëzimit plotësues i Ministrisë së Financave nr 1, datë 24.01.2024 “Për zbatimin e Buxhetit të vitit 2024”; Rezoluta e Kuvendit të Shqipërisë datw 04.12.2017 “Për Objektivat e Zhvillimit të Qëndrueshëm të Agjendës 2030 të shteteve anëtare të Kombeve të Bashkuara e datës 04.12.2017; VKB nr. 55, datë 29.12.2023 “Për miratimin e buxhetit te vitit 2024 dhe programit buxhetor afatmesëm përfundimtar 2024-2026 të Bashkisë Shkodër, i ndryshuar”; Marrëveshja Standarte Nr. 7926 Prot, datë 16.04.2024, mes Programit të Kombeve të Bashkuara për Zhvillim dhe Bashkisë Shkodër mbi zbatimin e Programit të Përbashkët të Kombeve të Bashkuara “Askush të mos mbetet pas” ku UNDP ka rolin e palës zbatuese për zbatimin e Projektit “Fuqizimi i komunitetit përmes ofrimit të shërbimeve ditore të alternuara për fëmijët dhe familjen”. si dhe pas shqyrtimit të materialit të përgatitur nga Administrata e Bashkisë.

## VENDOSI:

1. Të miratojë shtesën e planit dhe ndryshimin në buxhetin e Bashkisë Shkodër për projektin “Fuqizimi i komunitetit përmes ofrimit të shërbimeve ditore të alternuara për fëmijët dhe familjen”.
2. Projekti financohet në kuadër të “Leave No One Behind (LNB) – “Askush të mos mbetet pas”, udhëhequr dhe zbatuar nga Programi i Kombeve të Bashkuara për Zhvillim në Shqipëri – UNDP Albania, i financuar nga Agjencia Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim (SDC) për të mbështetur projekte në fushën e shërbimeve shoqërore me bazë komunitare të propozuara nga çdo bashki në Shqipëri.
3. Buxheti i Projektit i dedikuar për Bashkinë Shkodër është në vlerën 4,052,492 Lekë në total për të gjithë kohëzgjatjen e Projektit, ku përfshihet pjesa e financuar nga Programi (donatori) dhe kontributi i Bashkisë Shkodër për projektin.
4. Buxheti i financuar nga Programi (donatori) për Bashkinë Shkodër do të jetë 2,997,500 Lekë (73.97%), për të gjithë kohëzgjatjen e Projektit.
5. Bashkëfinancimi i Bashkisë Shkodër për Projektin do të jetë 1,054,992 lekë. 26.03%, me staf ekzistues për të gjithë kohëzgjatjen e Projektit.
6. Projekti do të zbatohet me llogari brenda thesari dhe do të përfshihet në programin 10430 “Kujdesi social për familjet dhe fëmijët” sipas tabelës së mëposhtme dhe fishës bashkëlidhur.

Shpenzimet e llogaritura					
Shpenzimet për çdo aktivitet	Totali	Nga kjo:			
	(Lek)	Paga	Sigurime shoq + shënd	Shpenzime Operative	Shpenzime e Kapitale
Shuma 2024	2,377,500	613,000	107,000	1,397,500	260,000
Shuma 2025	620,000	306,000	54,000	260,000	
Shuma totale e Projektit e financuar nga Projekti	2,997,500	919,000	161,000	1,657,500	260,000
<b>Totali</b>	<b>2,997,500</b>	<b>919,000</b>	<b>161,000</b>	<b>1,657,500</b>	<b>260,000</b>

7. Miratimin e shtesës së numrit të punonjësve dhe miratimin e nivelit të pagës për punonjësit e planifikuar me fondet e projektit për vitin 2024 dhe 2025. Projekti ka parashikuar të punësojë dy mësues mbështetës (part-time) 50% sipas angazhimit, i cili do të jetë 8 muaj në vitin 2024 dhe 4 muaj në vitin 2025. Fondi i përlllogaritur është marrë nga buxheti i projektit dhe shpenzimi mbulohet nga donatori.

Niveli i pagës do të jetë sipas tabelës së mëposhtme:

Emërtimi	Punonjës	I zgjedhur, I emëruar	Arsimi i lartë		Arsimi i mesëm	
			Kategoria	Pozicioni	Klasa	Paga Bazë Mujore
Specialist	2		IV-a	56,000		
Numri i Punonjësve	2					

Mësuesit mbështetës (part-time) do punojnë me kohë të pjesshme me 50% të kohës përgjatë gjithë kohëzgjatjes së projektit.

8. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Kryetari i Bashkisë.

9. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes.

**KRYETAR**

**Benet Beci**

Me Vendim Delegimi  
Zv/Kryetar  
Onid Bejleri

Zv/Kryetar

Drejtorja e Shërbimeve Sociale

Drejtorja Juridike

Drejtorja e Analizës dhe  
e Programimit Buxhetor

Drejtorja e Financës

Drejtorja e Burimeve Njerëzore



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA SHKODËR

KRYETAR

Nr. \_\_\_\_ Prot

Shkodër, më \_\_\_\_ . \_\_\_\_ .2024

## RELACION

**“PËR NJË SHITESË PLANI DHE NDRYSHIM NË BUXHETIN E BASHKISË SHKODËR PËR PROJEKTIN “FUQIZIMI I KOMUNITETIT PËRMES OFRIMIT TË SHËRBIMEVE DITORE TË ALTERNUARA PËR FËMIJËT DHE FAMILJEN”.**

**Drejtuar: Këshillit Bashkiak Shkodër**

**Të nderuar Këshilltarë!**

Këshilli Bashkiak Shkodër në mbledhjen e tij të datës \_\_\_\_ . \_\_\_\_ .2024, me propozim të Kryetarit të Bashkisë, në mbështetje të nenit 35 pika 1 shkronja “d”, nenit 54 shkronja “dh”, të ligjit nr.139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”, i ndryshuar ; nenit 20 pika 1 dhe 5, të ligjit nr. 68/2017 “Për financat vendore”, i ndryshuar ; të ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar; pika 190 e udhëzimit nr. 9, datë 20.3.2018 të Ministrisë të Financave dhe Ekonomisë “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit”, të ndryshuar, udhëzimit nr.35, datë 21.09.2020 “Për kontrollin, regjistrimin, përdorimin, rakordimin, raportimin dhe publikimin e fondeve të financimeve të huaja në kuadrin e marrëveshjeve ndërkombëtare”, të ndryshuar; Rezoluta e miratuar nga Kuvendi i Shqipërisë për Objektivat e Zhvillimit të Qëndrueshëm të Agjendës 2030 të shteteve anëtare të Kombeve të Bashkuara e datës 04.12.2017. Projekti mbështet zbatimin e vizionit të sektorit social në Shqipëri, në përputhje me Objektivat për Zhvillim të Qëndrueshëm (SDG-të) dhe aspiratat e vendit drejt integritimit evropian. Qëllimi i përgjithshëm i projektit është: Krijimi dhe fuqizimi i shërbimeve sociale me bazë komunitare të qëndrueshme dhe të standardizuara në mbështetje dhe përfshirje të fëmijëve dhe familjeve, që synojnë rritjen e aksesit në shërbime dhe mundësi, me qëllim final promovimin e përfshirjes sociale të tyre.

Në vazhdimësi të marrëveshjes standarde mes Programit të Kombeve të Bashkuara për Zhvillim dhe Bashkisë Shkodër mbi zbatimin e Programit të Përbashkët të Kombeve të Bashkuara “Askush të mos mbetet pas” ku UNDP ka rolin e palës zbatuese për zbatimin e Projektit “Fuqizimi i komunitetit përmes ofrimit të shërbimeve ditore të alternuara për

fëmijët dhe familjen” me Nr. 7926 Prot, datë 16.04.2024, ju dërgojmë këtë relacion “Për një shtesë plani dhe ndryshim në buxhetin e bashkisë Shkodër për projektin “Fuqizimi i komunitetit përmes ofrimit të shërbimeve ditore të alternuara për fëmijët dhe familjen”.

**Projekti “Fuqizimi i komunitetit përmes ofrimit të shërbimeve ditore të alternuara për fëmijët dhe familjen”, është shpallur fitues në kuadër thirrjes për projekte “Askush të Mos Mbetet Pas”, një program i përbashkët i Kombeve të Bashkuara, i financuar nga Agjencia Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim (SDC).**

Propozimi për ngritjen dhe fuqizimin e programeve ditore për fëmijët dhe familjet vjen si nevojë për shërbime mbështetëse për ofrimin e një pakete të plotë shërbimesh cilësore për përfituesit e qendrave komunitare. Vitet e fundit vihet re një nevojë e shtuar për rritje të shërbimeve në zonat interurbane të qytetit të cilat si pasojë e urbanizimit po preken nga probleme të shumta social-ekonomike. Gjatë punës në terren në procesin e menaxhimit të rasteve viktime të dhunës në familje, familjeve me kapacitet të ulët prindëror, viktime të mundshme trafikimit, viktime trafikimi apo raste të prindërve me probleme të shëndetit mendor jemi ndeshur me mjaft sfida në procesin e riintegrimit të tyre në komunitetet përkatëse e si pasojë në rritjen e mirëqënien e fëmijëve. Dy lagjet e qytetit nr.1 dhe nr.5 janë të vendosura në dy skajet lindore dhe perëndimore dhe janë zona heterogjene të krijuara rishtazi me popullata të ardhura si pasojë e lëvizjeve demografike të pas viteve '90. Këto lagje gjatë viteve të fundit me ngritjen e shërbimeve sociale në komunitet kanë tashmë struktura të ngritura funksionale për ofrimin e shërbimeve. Qendra Komunitare “Për familjen” nr. 5 është qendra e parë komunitare “Për Familjen” e krijuar në vitin 2016, e cila përgjatë këtyre viteve ka ofruar shërbime paschkollore, lojra psiko-sociale dhe aktivitete edukative për fëmijët dhe familjet, kryesisht në bazë të projekteve me donatorët. Qendra Multifunksionale “Xixëllonjat” është qendra më e re multifunksionale që i është shtuar bashkisë së Shkodrës. Në të dy qendrat komunitare ka ambiente të përshtatshme për realizimin e aktiviteteve për fëmijët dhe familjet. Ambientet të cilat ofrohen nga Bashkia Shkodër janë specifike për ofrimin e shërbimeve: klasa paschkollore, klasa prindërimi, lojra psiko-sociale brenda dhe jashtë ambienteve të qendrave (indoor out door activities). Ofrimi i këtyre shërbimeve ditore ndihmon në kontaktin periodik me familjet dhe fëmijët duke i orientuar dhe mbështetur në nevojat direkte dhe indirekte që mund të identifikohen.

#### **Kuadri ligjor:**

Ky projekt do të zbatohet në mbështetje të:

- Ligji nr. 121/2016 “Për Shërbimet e Kujdesit Shoqëror në Republikën e Shqipërisë”
- Planin Social Vendor të Bashkisë Shkodër 2018– 2021 Vendim nr. 84 , datë 20.12.2018.
- Rezolutës së miratuar nga Kuvendi i Shqipërisë për Objektivat e Zhvillimit të Qëndrueshëm të Agjendës 2030 të shteteve anëtare të Kombeve të Bashkuara, e datës 04.12.2017.

- Programit të Bashkëpunimit për Zhvillim të Qëndrueshëm ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Kombeve të Bashkuara 2017-2021, nënshkruar më 24 tetor 2016.

- Marrëveshja standarte mes Programit të Kombeve të Bashkuara për Zhvillim dhe Bashkisë Shkodër mbi zbatimin e Programit të Përbashkët të Kombeve të Bashkuara 'Askush të mos mbetet pas' ku UNDP ka rolin e palës zbatuese për zbatimin e Projektit "Fuqizimi i komunitetit përmes ofrimit të shërbimeve ditore të alternuara për fëmijët dhe familjen", me Nr. 7926 Prot, datë 16.04.2024

### **Kuadri i përgjithshëm:**

Programi Askush Të Mos Mbetet Pas, faza e dytë (LNB2) mbështetet mbi përvojën e gjerë të OKB-së në adresimin e përfshirjes sociale dhe nevojave të grupeve të rrezikuara. Projekti mbështet zbatimin e vizionit të sektorit social në Shqipëri, në përputhje me Objektivat për Zhvillim të Qëndrueshëm (SDG-të) dhe aspiratat e vendit drejt integritit evropian. Askush Të Mos Mbetet Pas (LNB2) shfrytëzon ekspertizën teknike dhe njohuritë e agjencive të OKB-së që synojnë ndikim dhe shtrirje më të madhe duke u fokusuar në nivel bashkie dhe në organizmat respektiv në nivel kombëtar. Qëllimi i fazes së dytë të këtij programi (2021 - 2025) është fuqizimi i personave dhe grupeve të rrezikuara për të pasur akses të barabartë në shërbimet dhe mundësitë publike, të thonë fjalën e tyre në vendimmarrje publike që ndikojnë në jetën e tyre dhe të vënë para përgjegjësisë zyrtarët në detyrë.

Meqenëse ofrimi i shërbimeve realizohet kryesisht në nivel lokal, edhe ndërhyrja fokusohet në nivel lokal. Dy prej tre rezultateve pasqyrojnë këtë shtysë - duke fuqizuar përfituesit në nevojë për masa për mbrojtje sociale për të pasur akses dhe për të kontribuar në përfshirjen e tyre sociale (rezultati 1), dhe duke i aftësuar bashkitë të ofrojnë shërbime dhe të promovojnë mbrojtjen dhe përfshirjen sociale (rezultati 2). Rezultati i tretë pasqyron qëllimin e projektit për ankorimin e ndërhyrjeve të tij në nivel sistemi; që është kontributi në hartimin dhe zbatimin e mëtejshëm të politikave të përshtatshme për përfshirjen sociale, përfshirë edhe financimin.

Në këtë linjë edhe Bashkia Shkodër është shpallur fituese e thirrjes me projektin "Fuqizimi i komunitetit përmes ofrimit të shërbimeve ditore të alternuara për fëmijët dhe familjen".

Planifikimi strategjik i shërbimeve të kujdesit social në Shkodër është bazuar në prioritetet dhe nevojat kryesore për shërbime të kujdesit shoqëror, të përcjella nga vetë komuniteti dhe aktorë kyç të Bashkisë. Ndaj vizioni i Bashkisë Shkodër në këtë drejtim është: "Shërbime sociale multisektoriale të qëndrueshme dhe të standardizuara pranë komunitetit në mbështetje dhe fuqizim të familjes si qeliza bazë e shoqërisë". Bazuar edhe në Planin Social, Bashkia Shkodër ka për qëllim të përmbushë nevojat për mbrojtje, përkujdesje, rehabilitim, përfshirje sociale dhe riintegrim të individëve, duke synuar një komunitet me familje dhe individë të mbrojtur dhe të fuqizuar.

Në këtë kuadër, **qëllimi i përgjithshëm** i projekt-propozimit është: Krijimi dhe fuqizimi i shërbimeve sociale me bazë komunitare të qëndrueshme dhe të standardizuara në mbështetje dhe përfshirje të fëmijëve dhe familjeve, që synojnë rritjen e aksesit në shërbime dhe mundësi, me qëllim final promovimin e përfshirjes sociale të tyre.

### **Buxheti i Projektit:**

Buxheti i Projektit i dedikuar për Bashkinë Shkodër është në vlerën 4,052,492 Lekë në total për të gjithë kohëzgjatjen e Projektit, ku përfshihet pjesa e financuar nga Programi (donatori) dhe bashkëfinancimi i Bashkisë Shkodër për projektin:

Buxheti i financuar nga Programi (donatori) për Bashkinë Shkodër do të jetë 2,997,500 Lekë (73.97%), për të gjithë kohëzgjatjen e Projektit.

Bashkëfinancimi i Bashkisë Shkodër për Projektin do të jetë 1,054,992 lekë. 26.03%, me staf ekzistues për të gjithë kohëzgjatjen e Projektit. Bashkia Shkodër do të bashkëfinancojë projektin me burimet e veta, sipas zërave: Paga dhe sigurime (staf ekzistues që ndjek projektin) për projektin dhe bashkëfinancimi do të mbulohet nga burimet ekzistuese dhe nuk kërkon kosto shtesë për financim.

### **Burimet Njerëzore:**

Miratimin e shtesës së numrit të punonjësve dhe miratimin e nivelit të pagës për punonjësit e planifikuar me fondet e projektit për vitin 2024 dhe 2025.

Projekti ka parashikuar të punësojë dy mësues mbështetës (part-time) 50% sipas angazhimit, i cili do të jetë 8 muaj në vitin 2024 dhe 4 muaj në vitin 2025.

Fondi i përlogaritur është marrë nga buxheti i projektit dhe shpenzimi për 2 punonjës mbështetës mbulohet nga donatori. Angazhimi do të jetë 8 muaj në vitin 2024 dhe 4 muaj në vitin 2025.

Punonjës me kontratë që paguhet nga donatori

(Viti 2024-2025)

Emërtimi	Punonjës	I zgjedhur, I emëruar	Arsimi i lartë		Arsimi i mesëm	
			Kategoria	Pozicioni	Klasa	Paga Bazë Mujore
Specialist (Mësues Mbështetës)	2		IV-a	56,000		
<b>Numri i Punonjësve</b>	<b>2</b>					

### **Objektivat e projektit:**

OS.1 Krijimi dhe fuqizimi i shërbimeve ditore për fëmijët dhe familjen pranë Qendrës Komunitare "Për Familjen" Nr.5 dhe Qendrës Multifunksionale Xixëllonjat.



OS.2 Përfshirja dhe fuqizimi i familjeve përmes shërbimeve ditore të alternuara për fëmijët dhe familjen” pranë Qendrës Komunitare “Për Familjen” Nr.5 dhe Qendrës Multifunksionale Xixëllonjat.

**Aktivitetet kryesore të projektit:**

**A.1:** Ofrimi i shërbimeve edukative passhkollore pranë hapësirave të Qendrave Komunitare “Për Familjen” Nr. 1 dhe Qendrës Multifunksionale Xixëllonjat në lagjen Nr.1 dhe 5.

**A.2:** Zhvillimi i një kampi veror për fëmijët përfitues të shërbimeve pranë Qendrave Komunitare “Për Familjen” Nr. 5 dhe Qendrës Multifunksionale Xixëllonjat në lagjen Nr.1 dhe 5.

**A.3:** Zhvillimi i një aktiviteti final përmbyllës me fëmijët dhe prindërit përfitues të shërbimeve pranë Qendrave Komunitare “Për Familjen” Nr. 5 dhe Qendrës Multifunksionale Xixëllonjat në lagjen Nr.1 dhe 5.

**Rezultatet kryesore të pritshme të projektit:**

Rezultati nr.1 : Dy (2) qendra të ngritura dhe funksionale që ofrojnë shërbime ditore cilësore për fëmijët dhe familjen.

Rezultati nr.2: Një (1) kamp veror i organizuar me fëmijët përfitues të shërbimeve.

Rezultati nr.3: Një (1) aktivitet final përmbyllës me fëmijët dhe prindërit përfitues të shërbimeve i organizuar.

**KRYETAR**


**Benet Beci**

Me Vendim Delegimi

Zv/Kryetar

Onid Bejleri

Drejtorja e Shërbimeve Sociale



Nr. 42	<b>Projekti:</b> P10430. Q4.02.A15 "Fuqizimi i komunitetit përmes ofrimit të shërbimeve ditore të alternuara për fëmijët dhe familjen"	<b>Funksioni 10:</b> MBROJTJA SOCIALE <b>N/Funksioni 104:</b> Familja dhe fëmijët <b>Programi 10430:</b> Kujdesi Sociale për Familjen dhe fëmijët
<b>a) Përshkrimi i shkurtër i projektit:</b>		
<b>i. Situata</b>		
<b>Kuadri i përqjithshëm:</b>		
<p>Projekti "Fuqizimi i komunitetit përmes ofrimit të shërbimeve ditore të alternuara për fëmijët dhe familjen", është shpallur fitues në kuadër thirrjes për projekte "Askush të Mos Mbetet Pas", një program i përbashkët i Kombeve të Bashkuara, i financuar nga Agjencia Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim (SDC).</p>		
<b>Kuadri ligjor:</b>		
<p>Ky projekt do të zbatohet në mbështetje të:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Ligji nr. 121/2016 "Për Shërbimet e Kujdesit Shoqëror në Republikën e Shqipërisë"</li> <li>- Planin Social Vendor të Bashkisë Shkodër 2018– 2021 Vendim nr. 84 , datë 20.12.2018.</li> <li>- Rezolutës së miratuar nga Kuvendi i Shqipërisë për Objektivat e Zhvillimit të Qëndrueshëm të Agjendës 2030 të shteteve anëtare të Kombeve të Bashkuara, e datës 04.12.2017.</li> <li>- Programit të Bashkëpunimit për Zhvillim të Qëndrueshëm ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Kombeve të Bashkuara 2017-2021, nënshkruar më 24 tetor 2016.</li> <li>- Marrëveshja standarte mes Programit të Kombeve të Bashkuara për Zhvillim dhe Bashkisë Shkodër mbi zbatimin e Programit të Përbashkët të Kombeve të Bashkuara 'Askush të mos mbetet pas' ku UNDP ka rolin e palës zbatuese për zbatimin e Projektit "Fuqizimi i komunitetit përmes ofrimit të shërbimeve ditore të alternuara për fëmijët dhe familjen", me Nr. 7926 Prot, datë 16.04.2024.</li> </ul>		
<p>Buxheti i Projektit i dedikuar për Bashkinë Shkodër është në vlerën 4,052,492 Lekë në total për të gjithë kohëzgjatjen e Projektit, ku përfshihet pjesa e financuar nga Programi (donatori) dhe bashkëfinancimi i Bashkisë Shkodër për projektin: Buxheti i financuar nga Programi (donatori) për Bashkinë Shkodër do të jetë 2,997,500 Lekë (73.97%), për të gjithë kohëzgjatjen e Projektit. Bashkëfinancimi i Bashkisë Shkodër për Projektin do të jetë 1,054,992 lekë. 26.03%, me staf ekzistues për të gjithë kohëzgjatjen e Projektit. Bashkia Shkodër do të bashkëfinancojë projektin me burimet e veta, sipas zërave: Paga dhe sigurime (staf ekzistues që nënkupton projektin) për projektin dhe bashkëfinancimi do të mbulohej nga burimet ekzistuese dhe nuk kërkon kosto shtesë për financim. Projekti ka parashikuar të punësojë dy punonjës në rolin e mësuesve mbështetës (part-time) 50% sipas angazhimit i cili do të jetë 8 muaj në vitin 2024 dhe 4 muaj në vitin 2025.</p>		
<b>ii. Synimi i projektit</b>		
<p>Qëllimi i përgjithshëm i propozimit është: Krijimi dhe fuqizimi i shërbimeve sociale me bazë komunitare të qëndrueshme dhe të standardizuara në mbështetje dhe përfshirje të fëmijëve dhe familjeve, që synojnë rritjen e aksesit në shërbime dhe mundësi, me qëllim final promovimin e përfshirjes sociale të tyre.</p>		
<b>iii. Aktivitetet kryesore të projektit</b>		
<p>A.1: Ofrimi i shërbimeve edukative passhkollore pranë hapësirave të Qendrave Komunitare "Për Familjen" Nr. 1 dhe Qendrës Multifunksionale Xixëllonjat në lagjen Nr.1 dhe 5.          A.2: Zhvillimi i një kampi veror për fëmijët përfitues të shërbimeve pranë Qendrave Komunitare "Për Familjen" Nr. 5 dhe Qendrës Multifunksionale Xixëllonjat në lagjen Nr.1 dhe 5.          A.3: Zhvillimi i një aktiviteti final përmbyllës me fëmijët dhe prindërit përfitues të shërbimeve pranë Qendrave Komunitare "Për Familjen" Nr. 5 dhe Qendrës Multifunksionale Xixëllonjat në lagjen Nr.1 dhe 5.</p>		
<b>b) Rezultatet që prisni</b>		
<ul style="list-style-type: none"> <li>▪ Rezultati nr.1 : Dy (2) qendra të ngritura dhe funksionale që ofrojnë shërbime ditore cilësore për fëmijët dhe familjen.</li> <li>▪ Rezultati nr.2: Një (1) kamp veror i organizuar me fëmijët përfitues të shërbimeve.</li> <li>▪ Rezultati nr.3: Një (1) aktiviteti final përmbyllës me fëmijët dhe prindërit përfitues të shërbimeve i organizuar.</li> </ul>		
<b>c) Aktorët e mundshëm</b>	<b>d) Kontributet e mundshme në projekt</b>	
<ul style="list-style-type: none"> <li>• Autoritetet vendore &amp; lokale;</li> <li>• Nëpunësit e qeverisjes lokale,</li> <li>• Organizatat e shoqërisë civile,</li> <li>• Media lokale,</li> <li>• Komuniteti në përgjithësi.</li> </ul>	Agjencia Kombëtare Franceze, Komisioni Bashkimit Evropian	

<b>e) Shpenzimet e llogaritura</b>						
Shpenzimet për çdo aktivitet 2024		Totali ( 000 lekë)	Nga kjo:			
			Paga	Sigurime shoq + shend.	Shpenzime Operative	Shpenzime kapitale
A.1	Paga për 2 punonjes Mësues Staf mbështetës (50 % të kohës)	720	613	107		
A.2	Ekspert për zhvillimin e klasave të prindërimit	144			144	
A.3	Blerje kondicionera	260				260
A.4	Blerje Materiale didaktike, kancelarike dhe psikosociale	600			600	
A.5	Kamp veror (transport, ushqim, bluza, lojra etj)	500			500	
A.6	Materiale promocionale (roll up, stilołapsa, baner me mekanizëm, canta doku	153.5			153.5	
<b>Shuma</b>		<b>2,377.5</b>	<b>613</b>	<b>107</b>	<b>1,397.5</b>	<b>260</b>
Shpenzimet për çdo aktivitet 2025		Totali ( 000 lekë)	Nga kjo:			
			Paga	Sigurime shoq + shend.	Shpenzime Operative	Shpenzime kapitale
A.1	Paga për 2 punonjes Mësues Staf mbështetës (50 % të kohës)	360	306	54		
A.2	Zhvillim aktiviteti përmbyllës i projektit (transport, dreka etj)	260			260	
<b>Shuma</b>		<b>620</b>	<b>306</b>	<b>54</b>	<b>260</b>	
<b>f) Periudha e zbatimit</b> 2024-2025			<b>g) Përgatiti dhe ndjek realizimin e projektit:</b> Drejtoria e Shërbimeve Sociale, Strehimit dhe Shëndetit Publik Institucioni likujdues: Bashkia Shkodër			